

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE  
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 08-151

Data/Date: 09 / 02 / 2022

Shtojca/Dodaci/Annex: -2-

PRISHTINË



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija- Department of  
Freelance Professions

**Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee**

**DPL.nr. 58/2021**

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbauesit privat z. \_\_\_\_\_ si organ përmbaues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_ pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbauesin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, të përmbauesit privat, z. \_\_\_\_\_ dhe z. \_\_\_\_\_ përfaqësuesi i autorizuar i \_\_\_\_\_ me seli në \_\_\_\_\_ me pas seancës këshillimore, me datën 27.01.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHEN** Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbauesin Privat, DPL. Nr 58/2021, datë 13.12.2021, si dhe ankesa e z. \_\_\_\_\_ përfaqësues i autorizuar i \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ dt 09.12.2021, si të pabazuara.

**A r s y e t i m**

Me datën 01.12.2021, përkatësisht 09.12.2021, z. Jeton \_\_\_\_\_ përfaqësues i autorizuar i \_\_\_\_\_ me seli në \_\_\_\_\_ ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbauesin Privat ndaj përmbauesit privat z. \_\_\_\_\_ Pala ankuese thekson që me datën 22.12.2020, në cilësi të palës kreditore ka iniciuar përmbauesin kundër palës debitore \_\_\_\_\_ mbi bazën e faturës nr 0008/19, F-00019/20, në vlerë prej 2,034.56 euro. Përmbauesi privat, sipas palës ankuese, ka lejuar përmbauesin sipas urdhrit përmbaues P. nr 870/20. Rrjedhimisht, pala ankuese thekson që debitori në emër të borxhit ka paguar shumën prej 757.21 euro me datën 21.01.2021. Nga kjo shumë, sipas palës ankuese, përmbauesi privat z. \_\_\_\_\_ ka transferuar në llogarinë e palës kreditore shumën

prej 629.29 euro me datën 18.12.2021. Si rezultat, me vonesë prej 29 ditësh. Pala ankuese pretendon që përkundër që prapësimi ndaj urdhrit përmbarimor ishte paraqitur tre (3) javë më vonë, dhe si i tillë ishte i pasafatshëm, përmbaruesi privat z. \_\_\_\_\_ ka kthyer prapa afatin për t'i mundësuar palës debitore paraqitjen e prapësimit. Ndërsa, duke mos njoftuar palën kreditore se ishte paraqitur prapësim, pala ankuese pretendon që ka humbur afatin për paraqitje të përgjigjes në prapësim. Po ashtu, pala ankuese thekson që përmbaruesi privat nuk i ka lëshuar faturë për ndalesat.

Me datën 13.12.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, pas shqyrtimit të çështies ka paraqitur në Komisionin Disiplinor Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat z. \_\_\_\_\_ si organ përmbarues i emëruar nga për Territorin e Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_ lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën P. nr 870/2020.

Përmbaruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim thekson se pretendimet për shkelje disiplinore janë të pabazuara. Lidhur me pretendimin për transferin e vonuar të shumës së përmbushur nga debitori në llogari të palës kreditore, përmbaruesi privat thekson se pala debitore ka përmbushur detyrimin ende pa marr formën e prerë urdhri përmbarimor. Rrjedhimisht konsiderohet që pagesa nga debitori ishte realizuar pa veprime përmbarimore. Po ashtu, përmbaruesi privat thekson që pala debitore kishte shprehur dyshime lidhur me vërtetësinë e faturës se e njëjta ishte fryrë njëdashëm nga kreditori. Prandaj kishte kërkuar kohë që t'i sqarojë çështjet dyshuese me palën kreditore si dhe kishte paraqitur prapësim, i cili është në procedurë pranë gjykatës kompetente. Për sa i përket kthimit të afatit për t'ia mundësuar palës debitore prapësimin, përmbaruesi privat, deklaron se Komisionit Disiplinor i ofron provat materiale - dëshminë e dërgesave të shkresave përmes postës. Lidhur me ndalesat, përmbaruesi privat thekson që është vepruar konform dispozitave të LPP- së për radhën e pagesave nga shuma e deponuara pasi që nga pagesat e realizuara së pari ndalen shpenzimet e procedurës përmbarimore. Rrjedhimisht, përmbaruesi privat kërkon refuzimin e ankesës.

Me datën 27.01.2022, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, përmbaruesi privat, z. \_\_\_\_\_ dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese z. \_\_\_\_\_ Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e Raport Përfundimtar duke theksuar se mbetet pranë të njëjtit. Po ashtu, përmbaruesi privat dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese, kanë ngelur pranë ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitura me shkrim dhe kanë bërë eleborimin e tyre.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesi privat z. \_\_\_\_\_ nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Komisioni Disiplinor gjen se përmbauesi privat z.

kishte lejuar përmbarimin me Urdhrin P. nr 870/20 të datës 22.12.2020, mbi bazën e dokumentit të besueshëm (faturës) nr F-000008/19 të datës 20.06.2019, nr F-000019, të datës 02.10.2020, nr F-000000021, të datës 06.11.2020, nr F-000000020, të datës 05.11.2020, në vlerë të përgjithshme prej 2,034.56 euro. Pala kreditore pretendon se vlera e përgjithshme e gjitha faturave është më e lartë se ajo e theksuar në urdhrin përmbarimor. Përmbauesi privat z.

, në anën tjetër, thekson që vet kreditori me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarim kishte njoftuar përmbauesin privat se pala debitore kishte përmbushur pjesërisht detyrimet sipas faturave të sipër cekura dhe kishte theksuar vlerën e detyrimit, e cila pastaj është shënuar në urdhrin përmbarimor.

Komisioni Disiplinor, bazuar në shkresat e lëndës, vlerëson që pala ankuese nuk ka arritur të provon përgjegjësinë disiplinore të përmbauesit privat z. me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbaimore. Vlera e detyrimit është shënuar në Propozimin për përmbarim ashtu edhe në Urdhrin përmbarimor P.nr 870/20 të datës 22.12.2020. Këto dokumente ishin në dispozicion të kreditorit. Komisioni Disiplinor nuk gjen prova që ankuesi të ketë ngritur shqetësime apo të ketë paraqitur më parë kundërshtime lidhur me vlerën e përgjithshme të detyrimit të theksuar në urdhrin përmbarimor. Pala debitore dhe kreditore qartazi kanë pikëpamje të ndryshme lidhur me detyrimet mes tyre. Kjo çështje është adresuar tashmë përmes mjeteve juridike në gjykatë. Është detyrë e gjykatës, e jo e Komisionit Disiplinor, të vendos meritorisht. Procedurat pranë Komisionit Disiplinor nuk janë procedura shtesë të procedurave ligjore apo zëvendësuese të tyre. Roli i Komisionit Disiplinor, në thelb, është i kufizuar në shkeljet disiplinore. Për sa i përket kthimit të afati për t'i mundësuar debitorit paraqitjen e prapësimit apo mosnjoftimin e kreditorit se është paraqitur prapësim për t'i pamundësuar përgjigjen në prapësim apo pretendimet lidhur me ndalesat, Komisioni Disiplinor gjithashtu është i kufizuar në analizën e vet për shkak se çështja është në procedurë gjyqësore pranë organeve kompetente sipas mjetit juridik-prapësimit. Megjithatë, është e qartë që pala ankuese bazuar në shkresat e lëndës ka paraqitur përgjigje në prapësim dt 02.02.2021. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor nuk gjen shkelje disiplinore nga ana e përmbauesit privat.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 58/2021, datë 27.01.2022**

**Kryesues i Komisionit Disiplinor**  
**Adnan ISUFI**



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

Faint, illegible text, likely bleed-through from the reverse side of the page. The text appears to be organized into several paragraphs, but the characters are too light and blurry to transcribe accurately.



Faint text centered below the seal, possibly a title or a line of a signature, which is illegible due to fading.

Faint text located in the lower-right area of the page, possibly a date or a reference number, which is illegible.

Faint text at the bottom of the page, possibly a footer or a concluding line, which is illegible.